



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1072/3 Prot.

Tiranë, më 22.05.2026

VENDIM

Nr. 78 dt. 22.05 2026

“PËR

MIRATIMIN E STRATEGJISË SË KËRKIMIT SHKENCOR TË UNIVERSITETIT TË  
SPORTEVE TË TIRANËS PËR PERIU DHËN 2026-2030”

Mbështetur në nenin 3 dhe 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-në nr. 57, datë 29.1.2020 “Për dhënien e Statusit të Veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në nenin 20 të Statutit të UST-së, Vendimin e Senatit Akademik nr.89, datë 01.08.2025 “Për propozimin e Planit Strategjik të zhvillimit të UST për periudhën 2026-2031”, Vendimin e Senatit Akademik nr.7, datë 28.09.2020, “Për miratimin e platformës së fushave të kërkimit shkencor në UST”, Vendimin e Rektoratit nr.79, datë 19.05.2026, Senati Akademik

VENDOSI

1. Të miratojë Strategjinë e Kërkimit Shkencor të Universitetit të Sporteve të Tiranës për periudhën 2026-2030 (bashkëlidhur).
2. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.
3. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim Njësive Kryesore të UST dhe për publikim Drejtorisë së Zhvillimit të Programebe dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA



## STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR (2026 – 2030)

### 1. Hyrje

Tendenca aktuale e zhvillimeve në Europë e në botë po bëjnë gjithmonë e më të qartë e të përcaktuar rolin dhe funksionimin e universitetit. Ka një rritje në drejtim të ndërkombëtarizimit dhe të mobiliteteve për universitetet, e në të njëjtën kohë janë rritur kërkesat në drejtim të cilësisë së kërkimit shkencor i cili është lidhur tashmë shumë ngusht me depërtimin shumë të shpejtë të teknologjive dhe inovacioneve në kërkim, si dhe në përmirësimin në manaxhim e të përdorimit me efikasitet të burimeve të disponueshme.

Me qëllim arritjen e një aktiviteti të suksesshëm *UST* duhet t'i përgjigjet në kohë reale zhvillimeve të tregut të Aktivitetit Fizik e Sportit në Shqipëri, si dhe të jetë fleksibël për t'u adaptuar në ndryshimet që ndodhin në ambjentin aktual. Kjo nuk do të thotë se *UST-ja* nuk do të respektojë traditën dhe eksperiencën pozitive të fituar e të konsoliduar në dekada.

Përgatitja e *Strategjisë së Kërkimit Shkencor* të veprimtarive të integruara (*këtu e në vazhdim Strategjia*) është një nga faktorët kuptimplotë për të siguruar një stabilitet e qëndrueshmëri për aktivitete të suksesshme në vijimësi, por dhe një udhërrëfyes efikas dhe i shpejtë në drejtim të cilësisë së shërbimeve me një standard ndërkombëtar, si dhe me një manaxhim modern të *UST-së*.

Strategji e re në zhvillimin e *UST-së* ka të bëjë me përsosjen e procesit të kërkimit shkencor nëpërmjet rritjes si nga ana sasiore dhe cilësore e standardit të projekteve kërkimore – studimore, protokolleve dhe teknologjisë që do të aplikohet, përmirësimin e laboratorëve, përhumbjen e studentëve në projektet kërkimore, si dhe integrimin e rezultateve të kërkimit në mësimdhënie.

Sjellja e *UST-së* gjithmonë e më shumë në dimensionet e standardeve të cilësisë, duke përbushur gjithmonë e më shumë kontributin dhe detyrën për një shërbim sa më të mirë dhe direkt në Sistemin Sportiv, Edukimin Fizik dhe Aktivitetin e Fizik e Shëndetin në Shqipëri do të jetë udhërrëfyesi për planifikimin e zhvillimin e punës në vijimësi.

### 2. Vizioni

- 2.1. Vizioni i *UST* synon shndërrimin e Universitetit në një Qendër ekspertize të specializuar në fushën e shkencave sportive, të edukimit fizik dhe shëndetit, të mirëqënies dhe rehabilitimit, të rekreacionit dhe turizmit. Synimi i mëtejshëm është kthimi i *UST* në një qendër ekselence që kontribuon në kërkimin shkencor në fushat e mësipërme. Këto synime *UST* përpiqet t'i realizojë në bashkupunime me partnerë të besueshëm.
- 2.2. Kërkimi shkencor në *UST* vihet në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së nivelit të kualifikimit dhe shkallës së ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore të shkencës në fushat e studimeve të sporteve, të edukimit fizik dhe shëndetit, të rekreacionit dhe turizmit si dhe në atë të

rehabilitimit fizik e shëndetësor tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore (referime në konferenca e seminare shkencore, botime, etj.)

- 2.3. UST do të ndërtojë dhe përmirësojë në vazhdimësi një infrastrukturë të kërkimit shkencor, për t'i dhënë frymarjen e duhur punës studimore të stafit akademik të vetë UST-së si dhe bashkëpunimit me institucione analoge brenda e jashtë vendit. Kjo do të arrihet mes fondeve të akorduara nga institucionet publike, private dhe organizma të tjerë kombëtare e ndërkombëtare.
- 2.4. Dokumenti i Strategjisë së Kërkimit Shkencor pasqyron frymën/filozofinë e realizimit të synimeve të mësipërme të UST-së. Për të realizuar këtë strategji do të përdoren: mekanizmat e implementimit të cilat përpunohen nga të gjitha Njësitë Kryesore të UST-së; përpunimit të planeve të integruara që realizohet nga Dekanatet; procesit të monitorimit dhe vlerësimit që përbën një detyrë parësore të Komisionit të Përhershëm të Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Botimeve Shkencore; financimit të projekteve një dhe shumëdisiplinore që miratohen nga ky komision dhe Bordi i Administrimit të UST-së.
- 2.5. Strategjia përvijohet në të njëjtën linjë me strategjinë e mësimdhënies, të nxënit dhe vlerësimit, strategjinë e teknikave dhe teknologjisë së informacionit si dhe me strategjinë e partneriteteve, të cilat shihen si interaktive me njëra tjetrën. Të gjitha këto strategji sektoriale përbëjnë strategjinë e UST-së.

#### **A. Parimet e Kërkimit Shkencor**

- 2.6. Strategjia mbështetet në statutin dhe dokumentet bazë të universitetit, në analizën e përvojës së fituar dhe në praktikat më të mira kombëtare e ndërkombëtare të cilat do të ndihmojnë në përmirësimin e profilit kërkimor e shkencor të UST-së.
- 2.7. UST zhvillon kërkim shkencor të qëndrueshëm dhe ndikon në hartimin dhe zbatimin e axhendës së kërkimit shkencor në rrafsh kombëtar duke demonstruar përfitimet konkrete të zhvillimit të një kërkimi bashkëkohor, mbështetur në arritjet aktuale të shkencës në fushën e sporteve, të edukimit fizik dhe shëndetit, të rekreacionit dhe turizmit si dhe në atë të rehabilitimit fizik e shëndetësor duke përdorur teknikat, aparaturat dhe teknologjinë bashkëkohore në përputhje me sfidat e zhvillimit.

#### **B. Objektivat Strategjike**

Nëpërmjet kërkimit shkencor UST është i vendosur:

- 2.8. Të arrijë dhe konsolidojë një vend dinjitoz midis universitetve me kurrikul të ngjashme në Shqipëri e Rajon e më gjerë.
- 2.9. Të ktheje UST në një qendër ku mundesohet aplikimi i zbulimeve shkencore në fushën e sporteve, të edukimit fizik dhe shëndetit, të rekreacionit dhe turizmit si dhe në ato të rehabilitimit fizik e shëndetësor.

- 2.10. Të nxisë bashkëpunimin e UST-së me biznesin e fushave të sporteve, të edukimit fizik dhe shëndetit, të rekreacionit dhe turizmit si dhe në ato të rehabilitimit fizik e shëndetësor për transferimin e eksperiencave të sukseshme në auditore dhe anasjelltas.
- 2.11. Të menaxhojë portofolin e financimit të kërkimit shkencor duke mbështetur me prioritet kërkimin e suksesshem që premtion zhvillimin dhe gjenerimin e axhendave të reja në fushen e sporteve, të edukimit fizik dhe shëndetit, të rekreacionit dhe turizmit si dhe në ato të rehabilitimit fizik e shëndetësor.
- 2.12. Të mirëmbaje dhe zhvillojë më tej infrastrukturën që inkurajon dhe mbështet kërkim shkencor të cilësisë së lartë, Synimet e UST-së për kërim shkencor kërkojnë investime të vazhdueshme për infrastrukturën në funksion të specialiteteve të krijuara apo inkurajuara ndër studentët. Për këtë arsye UST do i kushtojë vemendje përdorimit efektiv të mjediseve dhe infrastrukturës në dispozicion me qëllim mbështetjen e aktivitetit kërkimor të cilësisë së lartë.

#### **C. Indikatorët kritikë të suksesit**

- Staf akademik dhe studentë të ndërgjegjsuar për një kulturë institucionale që mbështet veprimtarinë krijuese.
- Staf aktual dhe ai i ri akademik të ndihet i vlersuar dhe pjese integrale e aktivitetit kërkimor të UST nëpërmjet pjesmarrjes në Grupet e Punës Kërkimore, në projekte të ndryshme.
- UST njeh në statutin e tij të drejtën për leje Sabatike për stafin akademik në institucion me qëllim thellimin në studime të caktuara dhe përgatitjen për botim të rezultateve të tyre në formë monografish edhe jashtë UST-së.
- UST mirpret një numër të gjërë studiuesish me reputacion kombëtar e ndërkombëtar dhe partneritet me institucione akademike të një standarti të lartë.
- Infrastruktura prezente në mbështetje të nevojave të stafit akademik të anagazhuar në veprimtari kërkimore shkencore.
- Akses i siguar për studentët në laboratorët e kërkimit të UST-së.

#### **D. Prioritetet**

Universiteti do të:

- Zgjerojë rrjetin e lidhjeve me institucione e qendra të kërkimit shkencor dhe do të ofrojë mbështetje për stafin akademik që të kryejë kërkimin shkencor, të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare apo aktivitete të tjera shkencore.

- Alokojë fonde dhe zhvillojë sisteme për mbështetjen efektive të kërkuesve të rinj, përfshirë trajnimin e kordinuar në përputhje me nevojat e tyre si dhe këshillim nga kërkues me përvojë.
- Të promovojë aktivitetin kërkimor të të gjitha njësive të UST-së.
- Sigurojë financime nga fonde të jashtme nëpërmjet pjesëmarrjes dhe aplikimit në projekte kombëtare e ndërkombëtare (por jo vetem) për të zhvilluar më tej bazën infrastrukturale dhe aftësitë implementuese të stafit akademik, me një rritje të përvitshme në masën 5% të fondeve të siguruara nga këto projekte.
- Adaptojë qasje krijuese për përdorimin e hapësirës egzistuese dhe zgjerimin e saj mbi bazën e investimeve të reja.
- Analizojë në mënyrë kritike dhe plotësojë në më të mirën e mundshme kërkesat/ nevojën për hapësirën e duhur për kërkim.
- Krijojë një bazë të dhënash elkektronike në mbështetje të kërkimit shkencor dhe evidentimit të aktivitetit kërkimor shkencor në UST.
- Rekrutojë dhe mbajë staf mbështetës me cilësi të lartë, të ofrojë trajnime për akademikët në menaxhimin e projekteve kërkimore dhe të sigurojë për ta infrastrukturë mbështetëse.
- Të përdorë fondet që burojnë nga projektet kërkimore për të përballuar kostot e zhvillimit të infrastrukturës mbështetëse për kërkimin shkencor.

### 3. Burimet

Aktiviteti kërkimor i UST financohet nga një sistem i dyfishtë: burimet e brendshme dhe donacionet apo financimet nga jashtë i ardhur në formën e grantit nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën.

Universiteti alokon fonde në mënyrë strategjike për Institutin e Kërkimeve dhe njësitë e tjera kryesore dhe bazë në mënyrë që ata të zhvillojnë kërkimin e tyre për shndërrimin e UST në qendër ekspertize të specializuar në kërkim shkencor duke lartësuar kështu profilin kërkimor të UST.

Fondet kryesore do të përqendrohen në financimin e projekteve kërkimore të paraqitura sipas një platforme të përcaktuar nga ana e studiuesve me reputacion kombëtar e ndërkombëtar, mbështetjen e kërkuesve të rinj dhe atyre në mes të karrierës, si dhe për balancimin e aktiviteteve kërkimore pa lënë pas dore mësimdhënien.

UST do të mbështesë zgjerimin e kërkimit shkencor ndërdisiplinor dhe të financimeve për këtë lloj kërkimi kryesisht nga buxheti i miratuar. UST do të mbështesë me prioritet aktivitete që kanë për qëllim ndërkombëtarizimin dhe forcimin e partneriteteve strategjike.

Fondet në mbështetje të kërkimit të UST-së do i jepen njesive bazë të Institutit të Kërkimit dhe Fakulteteve në mbështetje të iniciativave të tyre sipas një modeli të fondeve për zhvillimin e kërkimit shkencor të miratuara nga komisioni i përhershëm i Senatit Akademik i ngarkuar për kërkimin shkencor, projektet dhe botimet shkencore.